



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5142 Prot.

Roskovec, më 21.07 2021

VENDIM

NR. 60 .DATË 21.07.2021

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI”, Z.RRAPO KUKA

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, gërma k, dhe m; Ligjin nr. 112/2013. “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie dhe medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1- Dhënie e Titullit “Qytetar Nderi” i Bashkisë Roskovec për Z. Rrapo Kuka me motivacionin:

“ Për kontribute të mëdha që i ka dhënë zonës së Roskovecit Z.Kuka është njohur si një individ që vinte mbi gjithcka dashurinë për njerëzit dhe për atdheun si edhe zgjidhjen e problemeve që kishin. Z.Kuka ka luajtur rol të rëndësishëm në organizatat clirimtare të Shqipërisë, Ai u shqua si një drejtues i aftë e i vendosur në zgjidhjen e problemeve, si dhe një nga njerëzit më të nderuar të zonës së Roskovecit”.

2- Ngarkohet Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Shëndetësisë, Projekteve Sociale, Kordinimi me BE-në dhe Shërbimeve Komunitare për zbatimin e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

